

LIGJ PËR SHËRBIMIN PEDAGOGJIK

TEKST I KONSOLIDUAR Ligj për shërbimin pedagogjik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2011 dhe 41/2014).

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen qëllimet, organizimi, kompetencat, udhëheqja dhe autorizimet e Shërbimit Pedagogjik, si dhe çështje tjera me rëndësi për përparimin e personalitetit, zhvillimit psikologjik, social, kulturor dhe edukativo-arsimor të nxënësve në arsimin fillor, gjimnaz, artistik, të mesëm profesional dhe specializues, të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore, arsimit të rriturve dhe konviktet e nxënësve, si dhe botimi i librave shkollorë për arsimin fillor dhe të mesëm.

Neni 2

Shërbimi Pedagogjik është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) që për përparimin e zhvillimit personal, psikologjik, social, kulturor dhe edukativo-arsimor të fëmijëve dhe nxënësve, zbaton metoda bashkëkohore shkencore dhe profesionale.

Neni 3

(1) Organizimi i brendshëm i Shërbimit Pedagogjik përcaktohet në pajtim me kompetencat e veta, në bazë të ligjit, rregullave dhe akteve tjera që kanë të bëjnë me format organizuese dhe në pajtim me zhvillimin e rrjetit të institucioneve edukativo-arsimore

(2) Selia e Shërbimit Pedagogjik është në Shkup.

II. KOMPETENCAT E SHËRBIMIT PEDAGOGJIK

Neni 4

Për realizimin e punëve në kuadër të fushëveprimit të vet, Shërbimi Pedagogjik është kompetent që:

- të përpunojë modele të shërbimeve që do të zhvillohen në bashkëpunim me edukatorët, arsimtarët, drejtorët e shkollave, njësitë e vetadministrimit lokal dhe me prindërit e fëmijëve dhe të nxënësve në pajtim me nevojat e shkollës, konviktit të nxënësve ose institucionit tjetër edukativo-arsimor,
- të ofrojë ndihmë profesionale për fëmijët dhe nxënësit të cilët kanë nevojë për psikologun për fëmijë me mbajtjen e kontaktit të drejtpërdrejtë ose ndryshe, varësisht nga lloji i problemit,
- të organizojë punëtori dhe trajnime për zhvillimin e drejtë të fëmijëve dhe nxënësve, si dhe shfrytëzimin e drejtë të resurseve në disponim në institucionet edukativo-arsimore,
- të zhvillojë rrjet të decentralizuar të psikologëve për fëmijë që drejtpërdrejt ose tërthorazi

do t'u ndihmojë fëmijëve, nxënësve, prindërve, edukatorëve dhe arsimtarëve në arritjen e nivelit të kualitetit të zhvillimit personal, psikologjik, social, kulturor dhe edukativo-arsimor të fëmijëve dhe nxënësve nga neni 1 i këtij ligji,

- të japë mendime profesionale ministrit të Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri) për zhvillimin e politikës edukative dhe arsimore në Republikën e Maqedonisë,
- të përcjellë praktikat më të mira evropiane në psikologjinë e fëmijëve dhe të arsimit dhe në pajtim me përvojat zhvillon programe më bashkëkohore dhe vegla për zgjedhjen e problemeve aktuale në institucionet edukativo-arsimore,
- të nxisë dhe organizojë projekte lidhur me zhvillimin e psikologjisë kualitative edukativo-arsimore në institucionet edukativo-arsimore,
- të propozojë masa dhe plane për promovimin e shëndetit mendor të fëmijëve dhe të nxënësve,
- të bashkëpunojë me prindërit, fëmijët, edukatorët, nxënësit dhe me arsimtarët, të marrë pjesë në këshillimin e prindërve dhe të propozojë masa për tejkalimin e konflikteve të paraqitura,
- ministrit t'i propozojë Program për këshillimin e prindërve,
- të japë mendim profesional për sjelljen asociale dhe antisociale të nxënësit, përkatësisht për sjelljen amorale dhe joetike të nxënësit, kur prindi është i thirrur në këshillim për sjelljen e atillë të nxënësit,
- të sigurojë praninë e punonjësve të tij kur prindi ose kujdestari më shumë se dy herë është i thirrur në këshillim;
- të parashtrojë propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për prindërit të cilët nuk janë paraqitur të thirrjen për këshillim dhe të njëjtit nuk e kanë arsyetuar mungesën e vet,
- të kryejë evoluimin e karakteristikave të personalitetit për përshtatshmërinë për të punuar me nxënës dhe adoleshente, në veprimtarinë edukativo-arsimore (testi i personalitetit),
- të propozojë masa për përforcimin e përkrahjes, kujdesit dhe zhvillimit të mjedisit të shëndoshë të punës në institucionet edukativo-arsimore,
- të bashkëpunojë me drejtorët e konvikteve të nxënësve, të shkollave fillore dhe të mesme dhe vazhdimisht të njoftohen me problemet që paraqiten ndërmjet fëmijëve, edukatorëve dhe fëmijëve, nxënësve, nxënësve dhe arsimtarëve, arsimtarëve dhe prindërve, si dhe ndërmjet fëmijëve, prindërve dhe arsimtarëve, e që negativisht ndikojnë në zhvillimin psikologjik, social dhe edukativo-arsimor të fëmijëve dhe nxënësve si dhe të propozojë masa konkrete për tejkalimin e problemeve,
- të promovojë programe dhe masa për zhvillimin e potencialit psikologjik, social, kulturor dhe edukativo-arsimor të nxënësve,
- të propozojë programe dhe masa për zhvillim më kualitativ psikologjik, social, kulturor dhe edukativo-arsimor të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore,
- të kryejë punë profesionale administrative për Komisionin Nacional për Libra Shkollorë,
- të shpall konkurs publik për recensentë për dorëshkrimet e librave shkollorë dhe kryen zgjedhje nga kandidatët e paraqitur dhe
- të botojë katalog të librave shkollorë të miratuar për përdorim, në ueb faqen e Ministrisë.

III. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT PEDAGOGJIK

Neni 5

(1) Struktura organizative e Shërbimit Pedagogjik rregullohet me aktin për Organizimin e Ministrisë.

(2) Emri i vendeve të punës, detyrat dhe fushëveprimi i punës dhe numri i realizuesve në Shërbimin Pedagogjik, rregullohet me aktin për sistematizimin e vendeve të punës në Ministri.

Neni 6

Për kryerjen e punëve në kompetencë të Shërbimit Pedagogjik, e veçanërisht për kryerjen e punës edukative profesionale dhe punës instruktore të mentorit, të kuadrit edukativ arsimor dhe udhëheqës në institucionet edukative arsimore, krijohen forma organizative që përcaktohen me aktin për organizimin e Ministrisë.

Neni 7

(1) Punët nga kompetenca e Shërbimit Pedagogjik të përcaktuara në nenin 4 alinetë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të këtij ligji, i kryejnë nëpunësit shtetërorë të cilët krahas kushteve të përgjithshme për punësim të përcaktuara me ligj, i plotësojnë edhe kushtet e veçanta si vijojnë: **2**

- kanë së paku përvojë pesëvjeçare në punën edukativo- arsimore nga sfera e pedagogjisë dhe psikologjisë,
- kanë marrë pjesë në tubime shkencore dhe profesionale për edukim dhe arsim, me punimet e tyre nga sfera e psikologjisë dhe pedagogjisë dhe
- njohin së paku një gjuhë botërore.

(2) Gjatë punësimit të nëpunësve shtetërorë nga paragrafin (1) i këtij neni, zbatohet parimi i përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive, pa u prishur kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 8

(1) Për kryerjen e punës nga kompetenca e vet Shërbimi Pedagogjik drejtpërdrejt bashkëpunon me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit, institucionet e larta arsimore dhe shkencore, organet e komunave, komunave të qytetit të Shkupit, përkatësisht qytetit të Shkupit, shkollat, institucionet ndërkombëtare për edukim dhe arsim, si dhe me institucione dhe shoqata tjera.

(2) Për çështjet e përsosjes profesionale të shërbimeve pedagogjike psikologjike në institucionet edukativo-arsimore, Shërbimi Pedagogjik veçanërisht bashkëpunon me institucionet e larta arsimore dhe shkencore.

Drejtori i Shërbimit Pedagogjik

Neni 9

(1) Me punën e Shërbimit Pedagogjik udhëheq drejtori.

(2) Drejtori emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Për emërimin e drejtorit shpallet konkurs publik në së paku tri gazeta ditore të cilët botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që

botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. **3**

4

(4) Për drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose të kryer shkallën VII/ të arsimit;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në veprimtarinë edukative arsimore ose në organ të administratës shtetërore kompetente për punët e arsimit;
- 5) posedon një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare vijuese ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: **5**
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë,
 - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

(5) Mandati i drejtorit zgjat katër vite me mundësi për rizgjedhje.

(6) Drejtori mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, nëse:

- këtë vet e kërkon dhe
- vërtetohen parregullsi serioze në punën e tij me çfarë i është shkaktuar dëm Shërbimit Pedagogjik.

Neni 10

Drejtori i Shërbimit Pedagogjik i kryen këto punë:

- udhëheq me punën e Shërbimit Pedagogjik,
- e miraton programin vjetor për punën e Shërbimit Pedagogjik,
- e miraton raportin vjetor për punën e Shërbimit Pedagogjik,
- e organizon realizimin e programit vjetor,
- shpall konkurs publik për recensentë për dorëshkrimet e librave shkollorë,
- e bën zgjedhjen e recensentëve për dorëshkrimet e librave shkollorë dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 11

(1) Drejtori i Shërbimit Pedagogjik formon trupa këshillues dhe angazhon bashkëpunëtorë të jashtëm, nëpërmjet konkursit publik.

(2) Anëtarët e trupave këshilluese dhe bashkëpunëtorët e jashtëm nga paragrafi (1) i këtij neni, i zgjedh drejtori nga radhët e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet në konkursin publik.

IV. FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT PEDAGOGJIK

Neni 12

Mjetet për financimin e punës së Shërbimit Pedagogjik sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

Nëpunësit shtetërorë ekzistues në Shërbimin Pedagogjik, vazhdojnë t'i kryejnë punët në vendet e punës ku ndodhen para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, në pajtim me Ligjin për nëpunës shtetërorë.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".